




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL / ASSEMBLY OF MUNICIPALITY / SKUPSTINA OPŠTINA  
SKENDERAJ  
Nr. 01-463/01-0004925/26  
Data 03.02.2026



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/ Skupstina Opštine/Municipal Assembly

Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 2, shkronja d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, neni 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshëm të Komunës, neni 6 i Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunë, neni 50 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025, si dhe Harta Zonale e Komunës së Skenderaj, dhe neni 14 par. 1 dhe 2 shkronja d) të Statutit të Komunës së Skenderajt Nr.01-110-385, i datës 03.12.2008, **bazuar në Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-10/4, i datës; 26.01.2026**, Kuvendi i Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 30.01.2026 miratoi këtë:

## V E N D I M

(Për Rishqyrtimin e vendimit mbi publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2026)

### Neni 1

Miratohet propozimi Nr . 02 – 463/01-0004466/26 i datës; 30.01.2026 për rishqyrtimin -vendimi me Nr.01-463/01-0000466//26, të datës; 05.01.2026, mbi publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2026.

### Neni 2

Korrigjohet lista e pronave e hartuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duke ju shtuar këto të dhëna; Të dhënat Kadastrale të pronës, qëllimin, dëstinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, sipas **Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-10/4, i datës; 26.01.2026**.

### Neni 3

Pjesët tjera të Vendimit bazë Nr.01-463/01-0000466//26, të datës; 05.01.2026 mbi publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2026, mbesin ne fuqi dhe të pa ndryshuara.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronësi dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Ambientit, nen mbikëqyrje të Kryetari të Komunës.

### Neni 5


Ky vendim hyn në fuqi 30 dite pas regjistrimit në zyrën e regjistrimit te protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit te tij ne ueb-faqen e komunës.

**Këtij vendimi i bashkëngjiten:** Lista me të dhënat e përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim për vitin 2026, certifikatat e pronësisë dhe orto foto të pronave.

### Vendimi i Dërgohet :

- 1x1 Arkivit;
- 1x1 Zyrës së kryetarit;
- 1x1 DGJKP-së;
- 1x1 DUMA-së;
- 1x1 MAPL-së;

KRYESUESJA E KUVENDIT  
znj. Adelina Spahiu Altra





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SHUPËSTINA OPSTINE  
SKENDERAJ

Nr.  
No. 05-463/04-0004360/26  
Data.  
Data. 29. 01. 2026



Komuna Skënderaj  
Opstina Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

### Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Direkcija za Geodeziju, Kadastar i Imovinu  
Department of Geodesy, and Property Cadastre

<b>DATE/A:</b>	29.01.2026
<b>REFERENC-Ë</b>	
<b>PËR/ZA/TO</b>	Zyrën e Kryetarit Kuvendin e Komunës së Skenderajt
<b>NGA OD/FROM:</b>	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Shkresë përcjellëse

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, duke u bazuar në **LIGJIN NR. 06/L-092 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM DHE KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS**, si dhe bazuar në shkresën Nr. 020-10/4 të datës 26.01.2026 të nxjerrë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, propozon listën e përgjithshme të pronave në posedim të Komunës së Skenderajt si dhe listën e veçantë të pronave të paluajtshme të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për persona fizik dhe juridik gjatë vitit 2026.

Bashkangjitur me këtë shkresë gjeni:

- Listën e përgjithshme e pronave në posedim të Komunës së Skenderajt, dhe
- Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të planifikuara për dhënie në shfrytëzim për personat fizik dhe juridik gjatë vitit 2026.

Me respekt,

Granit Mustaj

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Assembly

**Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

Direkcija za Geodeziju, Kadastar i Imovinu  
Department of Geodesy, and Property Cadastre

**Lista e veçantë e pronave të paluajtshme komunale që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për personat fizik dhe juridik gjatë vitit 2026**

Nr.	Pronari (Poseuesi)	Nr. i Parcelave	Sipërfaqja e Përgjithshme m2	Qëllimi i dhënies në Shfrytëzim	Zona Kadastrale	Periudha e dhënies në shfrytëzim
1.	Komuna Skenderaj	563-2 563-1 568-0 569-0 579-0 699-10 699-11 700-0 565-2 669-1 551-0 671-0 640-0 1070-1 668-0 562-4 241-2 570-1 581-3 586-0 672-0	1895 m2 7925 m2 5900 m2 12250 m2 13645 m2 941 m2 3965 m2 7265 m2 1748 m2 1238m2 28276 m2 186320 m2 1799 m2 510 m2 2518 m2 7768 m2 1000m2 4342 m2 1828 m2 1622 m2 6157m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Skenderaj	Afatgjatë
2.	Komuna Skenderaj	47-0 48-1 49-0	1281 m2 374 m2 1291 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Skenderaj	Me qira 0-1 Vit

3.	<b>Ndërtesat e Organit K.K. Skenderaj</b>	588 - 7	1119 m <sup>2</sup>	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Skenderaj	Afatgjatë
4.	<b>Pasuri Shoqërore - Rrugë Publike</b>	565 - 2 564-0 566-0	1748.4 m <sup>2</sup> 851 m <sup>2</sup> 280 m <sup>2</sup>	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Skenderaj	Afatgjatë
5.	<b>Pasuri Shoqërore - Rrugë Publike</b>	816-0 75-0	31808 m <sup>2</sup> 7462 m <sup>2</sup>	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Skenderaj	Me qira 0-1 vit
6.	<b>Pasuri Shoqërore - Ndërmarrja Komunale Shërbyese 18 Nëntori</b>	669-2	1000 m <sup>2</sup>	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Skenderaj	Afatgjatë
7.	<b>Komuna Skenderaj</b>	13-1 16-0 17-1 17-2 434-0 435-0 436-0 437-0 476-0 494-0 495-0 496-0 901-0 438 - 0	11994 m <sup>2</sup> 3456 m <sup>2</sup> 24463 m <sup>2</sup> 1280 m <sup>2</sup> 12358 m <sup>2</sup> 51624 m <sup>2</sup> 62140 m <sup>2</sup> 1964 m <sup>2</sup> 2816 m <sup>2</sup> 1757 m <sup>2</sup> 31154 m <sup>2</sup> 17520 m <sup>2</sup> 22519 m <sup>2</sup> 6001 m <sup>2</sup>	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Klinë e Poshtme	Afatgjatë


8.	Pasuri Shoqërore – P.SH - Rrugët	501-0 902 – 0	5006 m2 3675 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Klinë e Poshtme	Afatgjatë
9.	Pasuri Shoqërore – P.SH - Ujërat	976-0	17612 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Prekaz i Poshtëm	Afatgjatë
10.	Komuna Skenderaj	1075-0 1338-0 1339-0 1340-0 1341-0 1342-0 1344-0 1345-0 2063-2	3255 m2 963 m2 519 m2 289 m2 279 m2 389 m2 120 m2 120 m2 22374 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Runik	Me qira 0-1 vit
11.	Komuna Skenderaj	992-0	12332 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Likoc	Me qira 0-1 vit
12.	Komuna Skenderaj	218-0 220-0 217-0	4899 m2 4949 m2 24264 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Çirez	Me qira 0-1 vit
13.	Komuna Skenderaj	655-0 656-0 235-0	350092 m2 199867 m2 20641 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve	Polac i Ri	Me qira 0-1 vit

				te planifikimit hapësinor		
14.	<b>Komuna Skenderaj</b>	244-0	4016 m2	Zhvillim Ekonomik / Interes Publik / Sipas dokumenteve te planifikimit hapësinor	Turiqec	Me qira 0-1 vit

Skënderaj, 29.01.2026

Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë



 <b>DALËSE - IZLAZNA - OUTGOING</b> REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministrastvo Lokalne Samouprave / Administracije Ministry of Local Government Administration	
Nr. Br. No.	020-10/9
Data Datum Date	23.02.2026



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
 Ministrastvo Administracije Lokalne Samouprave  
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Sami Lushtaku, Kryetar i Komunës së Skenderajt Adelina Spahiu-Alija, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Skenderajt	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Data: 10.02.2026 VI-020-10/6
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Donjeta Cakolli, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Skenderajt	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
E nderuar Kryesuese,

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.01-463/01-0004925/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-463/01-0000466/26 mbi publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim personave

23.02.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

#### Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Skenderajt në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026, ka miratuar, vendimi Nr.01-463/01-0004925/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-463/01-0000466/26 mbi publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2026.

MAPL, konstaton se akti i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Skenderajt, është i bazuar në nenin 11,12 paragrafi 2 shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, vendimi Nr.01-463/01-0004925/26 për rishqyrtimin e vendimit Nr.01-463/01-0000466/26 mbi publikimin e listës së përgjithshme dhe të veçantë të pronave të paluajtshme të komunës së Skenderajt, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim personave fizik/juridik për vitin 2026 i datës 30.01.2026, është miratuar në mbledhjen e rregullt të kuvendit të komunës së Skenderajt me, 21 vota për, 2 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.